

POLITIKË PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË ISHP LABORATORI AVICENA

Mbrojtjen e të dhënave personale ISHP LABORATORI AVICENA e siguron për pacientët, bashkëpunëtorët, të punësuarit e saj dhe për të gjitha subjektet e tjera (persona fizikë për të cilët sillen të dhënat e përpunuara), të dhënat personale e të cilëve mbi çfarëdo lloj baze (pajtueshmëri, kontratë etj) në çfarëdo lloj mënyrë përpunohen në ISHP LABORATORI AVICENA.

Shprehje të caktuara që janë të përdorur në këtë Politikë dhe janë të lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale, e kanë të njëjtin kuptim si edhe shprehjet që janë të parashikuara me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/2005, 103/2008, 124/2008, 124/2010, 135/2011, 43/2014, 153/2015 dhe 99/2016).

1. Të dhënat personale në ISHP LABORATORI AVICENA përpunohen ekskluzivisht në pajtueshmëri me vlefshmërinë momentale të dispozitave ligjore dhe nënligjore nga fusha e mbrojtjes e të dhënave personale, si edhe rregullorja ligjore dhe nënligjore nga fusha e mbrojtjes shëndetësore dhe rregullimin e punës së institucioneve shëndetësore.
2. Mbrojtja e të dhënave personale i garantohet çdo personi fizik pa diskriminim të themeluar mbi nacionalitetin, racën, ngjyrën e lëkurës, besimin fetar, përkatësinë etnike, gjininë, gjuhën, besimin politik etj, pozicionin material, prejardhjen e lindjes, arsimin, prejardhjen sociale, shtetësinë, vendin dhe llojin e qëndrimit, orientimit seksual ose mbi çfarëdo lloj karakteristike personale.
3. Të dhënat personale mbliidhen, përdoren dhe ruhen për qëllime konkrete, të qarta dhe qëllime të përcaktuara me ligj dhe përpunohen në mënyrë që është në pajtueshmëri me ato qëllime. Të dhënat personale të subjekteve ruhen në formë që mundëson identifikim të subjektit me të dhëna personale, jo më gjatë se periudha që është e nevojshme për t'u plotësuar qëllimet për çka janë mbledhur të dhënat për përpunim të mëtejshëm.
4. ISHP LABORATORI AVICENA siguron besueshmërinë e plotë, integritetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve. Laboratori ynë i ndërmerret të gjitha masat e domosdoshme organizative, administrative, teknike dhe fizike për mbrojtjen e të dhënave personale që përpunohen dhe të njëjtat ato të dhëna, në çdo kohë, i mbron nga shkatërrimi i rastësishëm ose joligjor, nga humbja, ndryshimi, zbulimi ose qasja e paautorizuar ose edhe nga çfarëdo lloj formash të paligjshme të përpunimit.

5. Të dhënat personale që ISHP LABORATORI AVICENA i mbledh do të jenë të përshtatshme, relevante dhe jo shumë vëllimore në krahasim me qëllimet për të cilat ato mblidhen dhe përpunohen.
6. Të gjithë të punësuarit në ISHP LABORATORI AVICENA janë të obliguar që në pajtueshmëri me rregulloren ligjore dhe nënligjore, si edhe me aktet e brendshme, të kujdesen për mbrojtjen e të dhënave personale. Të punësuarit në ISHP LABORATORI AVICENA janë të obliguar që ta raportojnë çdo rast të lëndimit nga mbrojtja e të dhënave personale tek menaxherët e drejtpërdrejtë.
7. ISHP LABORATORI AVICENA nuk do t'i bëjë të disponueshme të dhënat personale që përpunohen para palëve të treta, përveç në rast ku ajo është e parashikuar me ligj, me qëllim që t'i shfrytëzojë të drejtat e tij ose t'i mbrojë interesat e tij ose të veprjë sipas kërkesave/urdrave gjyqësore ose kërkesave/urdrave nga ana e organeve të tjera shtetërore të autorizuara me ligj dhe institucione ose Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale.
8. Çdo subjekt i të dhënave personale ka të drejtë që të dorëzojë Kërkesë për qasje dhe rregullim për të dhënat e tij personale të cilat ISHP LABORATORI AVICENA i përpunon.
9. Të dhënat personale që mblidhen nëpërmjet faqes së internetit www.avicenalab.com.mk, ISHP LABORATORI AVICENA i përpunon në pajtueshmëri me dispozitat e përcaktuara më lart në këtë politikë.

Për çfarëdo lloj pyetjesh që sillen për mbrojtjen e të dhënave personale, subjektet janë të autorizuara që në çdo kohë të na kontaktojnë në lab@avicenalab.com.mk.

Nëse ka ndonjë ndryshim në politikën tonë për mbrojtjen e të dhënave personale, ato do të inkorporohen në mënyrë të përshtatshme në këtë dokument dhe do të publikohen në vend të dukshëm për të gjitha subjektet.

Me respekt,

ISHP LABORATORI AVICENA